

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 15, datë 26.5.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 8.1.2009, “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PËRDORIMIN E APARATEVE TELEVIZIVE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe nenit 11 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, ministri i Financave dhe drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 1, datë 8.1.2009, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shtojca 1 zëvendësohet me “shtojcën 1” bashkëlidhur këtij udhëzimi, si pjesë integrale e tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**DREJTORI
I PËRGJITHSHËM I RTSH
Martin Leka**

**MINISTRI I
FINANCIVE
Shkëlqim Cani**

SHTOJCA NR. 1

INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT MBI KATEGORITË E PËRJASHTUARA

Emërtimi, përshkrimi i kategorive, institucionet përgjegjëse për dhënien e informacionit mbi kategoritë e përjashtuara

Invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbrit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesit nazifashist të popullit shqiptar”, të ndryshuar, ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit” dhe ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”.

Të verbrit/ paraplegjikë/tetraplegjikë, Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH).

Veteranë lufte, Ministria e Mbrojtjes.

Invalid pune, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH).

Përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë në bazë të parimit të reciprocitetit, ambasadat Ministria e Punëve të Jashtme.

Bashkësitë fetare: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike në Shqipëri, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, Komuniteti Shtetëror për Kultet.

Faturimi i energjisë elektrike për aktivitete, të tilla si: miniera, ujësjellës, pusët e naftës, furnizimi i antenave të telefonisë celulare, ndriçimi publik i rrugëve dhe garazhet e mjeteve lëvizëse, miniera, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Ujësjellës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Puse naftë, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Antena celulare, AKEP (Agjencia e Komunikimeve Elektronike).

Ndriçimi publik i rrugëve, bashkitë.

Garazhet e mjeteve lëvizëse, sipas përcaktimeve të bëra në faturën e energjisë.